



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Lënda: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 tetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje
për Apelimin e Vendimit të 18 Shtatorit 2024 (F02598)**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJUKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të nenit 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 shtator 2024, pasi dëgjoi parashtrimet e palëve,¹ Trupi Gjykues lëshoi urdhër gojor me të cilin lejoi disa pyetje të një lloji të caktuar për W01129-en gjatë marrjes në pyetje prej Prokurorisë ("Vendimi i Kundërshtuar").²
2. Më 25 shtator 2024, ekipet e Mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, "Mbrojtja" dhe "të akuzuarit"), parashtruan kërkesë të përbashkët për leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").³
3. Më 7 tetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi përgjigjen ndaj Kërkesës ("Përgjigja").⁴
4. Më 14 tetor 2024, Mbrojtja dorëzoi kundërpërgjigjen e përbashkët ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigja").⁵

¹ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19970, rreshti 13, deri në f. 19980, rreshti 19, konfidencial.

² Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19981, rreshti 11, deri në f. 19983, rreshti 3, konfidencial.

³ F02598, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit të 18 shtatorit 2024*, 25 shtator 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 4 tetor 2024, F02598/RED).

⁴ F02623, Prokurorja e Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit të 18 shtatorit 2024* (F02598), 7 tetor 2024, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02623/RED).

⁵ F02650, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes lidhur me Përgjigjen e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit të 18 shtatorit 2024* (F02623), 14 tetor 2024, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

5. Mbrojtja kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar në lidhje me katër pikat e mëposhtme (bashkërisht, “pikat”):

- 1) nëse Trupi Gjykses gaboi që lëshoi vendim mospërputhës me një vendim të mëparshëm kur nuk kishte ndryshim të rrethanave që do të përlligjte devijimin nga vendimi i mëparshëm (“pika e parë”);
- 2) nëse Trupi Gjykses gaboi në Vendimin e vet kur ngatërroi dy aspekte të ndryshme të provës, çka rezultoi në gabime në arsyetim (“pika e dytë”);
- 3) nëse ishte i gabuar arsyetimi i Trupit Gjykses në lidhje me qëllimin e pranimit të kësaj prove, çka ndikoi në vlefshmërinë dhe bazën e Vendimit (“pika e tretë”); dhe
- 4) nëse Trupi Gjykses gaboi në Vendimin e vet kur vlerësoi në mënyrë të gabuar dëmin që shkaktohet me pranimin e provës në fjalë (“pika e katërt”).⁶

6. Mbrojtja parashtron se pikat përmbushin standardin e lejes për apel, duke qenë se: (i) burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nuk janë thjesht mospajtim me atë Vendim;⁷ (ii) mund të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit;⁸ dhe (iii) bëjnë të nevojshëm një vendim të menjëhershëm të Panelit të Gjykatës së Apelit, për të avancuar thelbësisht procesin.⁹

7. ZPS-ja përgjigjet se Kërkesa duhet të rrëzohet pasi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në Ligj dhe Rregullore.¹⁰ Konkretisht, ZPS-ja pretendon se pikat nuk janë të apelueshme, meqenëse janë thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.¹¹ Si alternativë, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se: (i) pikat ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit;

⁶ Kërkesa, para. 1-2, 28.

⁷ Kërkesa, para. 6, 7-24.

⁸ Kërkesa, para. 6, 25.

⁹ Kërkesa, para. 6, 26.

¹⁰ Përgjigja, para. 1, 22, 24.

¹¹ Përgjigja, para. 2, 4-18.

dhe (ii) një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit do të avanconte thelbësisht procesin.¹²

8. Mbrojtja kundërpërgjigjet se ZPS-ja shtrembëron Kërkesën dhe nuk e mbështet argumentin e vet se Kërkesa është thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.¹³ Gjithashtu, Mbrojtja: (i) rithekson se pikat janë të apelueshme dhe se leja për apelimin e tyre duhet të miratohet;¹⁴ dhe (ii) parashtron se dëmi që shkaktohet me Vendimin e Kundërshtuar është i qartë dhe ndikon ndjeshëm në procesin gjyqësor.¹⁵

III. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

9. Sipas nenit 45(2) dhe rregullës 77(2), e drejta për apel lind vetëm nëse është përmbushur standardi i miratimit të lejes për apel, i përcaktuar në këto dispozita.

Rregulla 77(2) përcakton se:

Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.

10. Trupi Gjykues përfshin, me anë të referencave, dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me standardin ligjor të miratimit të lejes për apel, të përcaktuar në vendime të mëparshme.¹⁶

¹² Përgjigjja, para. 2, 19-21.

¹³ Kundërpërgjigjja, para. 2.

¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 2, 6, 11, 15, 18, 22.

¹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 19-20.

¹⁶ *Shih* F01237, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Nxjerrjen e Informacionit për Dëshmitarët me Status të Dyfishtë*, 30 janar 2023, para. 7-8; KSC-BC-2020-07, F00423, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së për Leje për Apelim të Vendimit F00413 dhe Efekt Pezullues*, 8 nëntor 2021, para. 13-21; F00372, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Miratimin e Lejes për Apelim të F00328*, 15 tetor 2021, para. 15-17; F00484, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të F00470*, 8 dhjetor 2021, para. 4-14. *Shih gjithashtu* F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, para. 6-7, 9-17.

IV. DISKUTIM

11. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykues autorizoi ZPS-në që t'i bënte pyetje W01129-ës në lidhje me pretendime për rrëmbimin e punonjësve të një ndërmarrjeje në vitin 1998, përfshirë në lidhje me një person serb të përmendur me emër, për të cilat nuk janë ngritur akuza. Konkretisht, Trupi Gjykues konstatoi se pyetjet e propozuara: (i) ishin relevante për qartësimin e kontekstit përkatës dhe vërtetimin e një praktike sjelljeje të qëllimshme; dhe (ii) nuk do t'i shkaktonin dëm Mbrojtjes.¹⁷

A. PIKA E PARË

12. Mbrojtja parashtroi se, kur lejoi paraqitjen e provave të një lloji të caktuar përmes dëshmisë së W01129-ës për vërtetësinë e përmbajtjes së saj, Trupi Gjykues devijoi nga një vendim i vet i mëparshëm, pa pasur ndonjë ndryshim të arsyetueshëm ose të identifikueshëm të rrethanave. Konkretisht, Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykues më parë kishte refuzuar pranimin e provave të këtij lloji për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.¹⁸

13. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja nuk identifikon ndonjë aspekt të qartë dhe të ndryshëm që buron nga Vendimi, duke qenë se: (i) përsërit argumentet që tashmë i ka ngritur para Trupit Gjykues; (ii) shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se devijon nga një vendim i mëparshëm i Trupit Gjykues; dhe (iii) thjesht nuk pajtohet me konstatimet në të.¹⁹

14. Mbrojtja kundërpërgjigjet se pikërisht devijimi prej Trupit Gjykues nga vendimi i vet i mëparshëm në rrethana thelbësisht të ngjashme, përbën aspekt të ndryshëm që buron nga Vendimi i Kundërshtuar, dhe rithekson parashtrimet e bëra në Kërkesë.²⁰

¹⁷ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19981, rreshti 11, deri në f. 19983, rreshti 3, konfidencial.

¹⁸ Kërkesa, para. 7.

¹⁹ Përgjigja, para. 4-7.

²⁰ Kundërpërgjigja, para. 3-6.

15. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar shqyrtoi veçanërisht nëse ZPS-ja duhej të lejohej të merrte prova nga W01129, apo të paraqiste si prova dokumente në lidhje me incidentin e pretenduar për të provuar vërtetësinë e fakteve të paraqitura në to,²¹ pikërisht duke mbajtur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes lidhur me këtë pikë.²² Trupi Gjykses përfundimisht u bind se, duke pasur parasysh rrethanat specifike që iu parashtruan dhe duke vënë në dukje konstatimet e bëra në një vendim tjetër të mëparshëm,²³ pyetjet e propozuara nga ZPS-ja ishin relevante për qartësimin e kontekstit përkatës dhe vërtetimin e një praktike sjelljeje të qëllimshme.²⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është i mendimit se pika e parë është thjesht mospajtim me arsyetimin e Trupit Gjykses të përshkruar më lart, përmes përsëritjes së argumenteve të njëjta të bëra para Vendimit të Kundërshtuar.²⁵ Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e parë përbën një aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

16. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e parë. Rrjedhimisht rrëzohet kërkesa për leje për apelimin e pikës së parë.

²¹ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19981, rreshtat 17-21, konfidencial.

²² *Shih, p.sh.*, transkriptin e seancës, 18 shtator 2024, f. 19971, rreshtat 2-7; f. 19973, rreshti 11, deri në f. 19974, rreshti 5, konfidencial.

²³ *Krahaso* transkriptin e seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 2-5, konfidencial, me formulimin pothuajse të njëjtë me F02393, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Selimit për Përjashtimin e Provave të W04846-ës* ("Vendimi për Përjashtimin e Provave"), 19 qershor 2024, konfidencial, para. 16 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02393/RED). *Shih, për ngjashmëri*, F02464, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve W00686, W02765, W04491, W04694, W04782, W04788, W04820, dhe W04837 sipas Rregullës 153*, 22 korrik 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02464/RED), para. 57.

²⁴ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 6-9, konfidencial.

²⁵ *Krahaso* transkriptin e seancës, 18 shtator 2024, f. 19971, rreshtat 2-7; f. 19973, rreshtat 13-24, konfidencial, me Kërkesën, para. 7.

B. PIKA E DYTË

17. Mbrojtja pretendon se në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses ngatërroi dy aspekte të ndryshme të provës, përkatësisht: (i) rrëmbimin e një personi serb (“incidenti i parë”); dhe (ii) rrëmbimin e punonjësve të një kompanie (“incidenti i dytë”).²⁶ Mbrojtja argumenton se duke e konsideruar incidentin e parë si pjesë të incidentit të dytë, Trupi Gjykses nuk mori parasysh llojin specifik provues dhe historikun procedural të incidentit të dytë, as kundërshtimet e ndryshme të ngritura nga Mbrojtja.²⁷

18. ZPS-ja përgjigjet se në Vendimin e Kundërshtuar duket qartë se u morën parasysh të dy incidentet, dhe se, rrjedhimisht, Mbrojtja: (i) shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar; (ii) nuk identifikon gabime konkrete në arsyetimin e Trupit Gjykses; dhe (iii) nuk identifikon asnjë pikë të apelueshme konkrete dhe të ndryshme.²⁸

19. Mbrojtja kundërpërgjigjet se, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së, Vendimi i Kundërshtuar nuk përmban ndonjë arsyetim që vë në dukje se u morën parasysh të dy incidentet. Gjithashtu, Mbrojtja argumenton se, kur autorizon paraqitjen e provave në lidhje me incidente për të cilat nuk janë ngritur akuza, Trupi Gjykses duhet të tregojë kujdes të veçantë dhe të mbajë parasysh hollësitë konkrete të pretendimeve që kërkohet të paraqiten.²⁹

20. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar i shqyrtoi pyetjet e propozuara nga ZPS-ja në lidhje me “rrëmbimin [e punonjësve të një kompanie] në vitin 1998, përfshirë [të një personi serb të përmendur me emër]”,³⁰ duke e përfshirë si incidentin e parë, ashtu dhe incidentin e dytë, në një kontekst më të gjerë. Gjatë shqyrtimit, Trupi Gjykses vlerësoi të gjitha elementet relevante të të dy incidenteve. Trupi Gjykses rrjedhimisht është i mendimit se pika e dytë interpreton gabimisht

²⁶ Kërkesa, para. 8.

²⁷ Kërkesa, para. 9-13.

²⁸ Përgjigjja, para. 8-11.

²⁹ Kundërpërgjigjja, para. 8-10.

³⁰ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19981, rreshtat 11-13, dhe f. 19983, rreshtat 1-2, konfidencial.

Vendimin e Kundërshtuar kur thuhet se Trupi Gjykses e konsideroi incidentin e parë si pjesë të incidentit të dytë dhe për pasojë nuk mori parasysh rrethanat e ndryshme të tyre. Trupi Gjykses gjithashtu gjykon se pika e dytë është thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar dhe veçanërisht me rezultatin e vlerësimit prej Trupit Gjykses të aspekteve dhe kundërshtimeve të trajtuara më parë. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e dytë përbën një aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

21. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e dytë. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së dytë rrëzohet.

C. PIKA E TRETË

22. Mbrojtja parashtrohet se Trupi Gjykses gaboi në arsyetimin e vet sa i përket pranimin të provës së marrë nga W01129 për qartësimin e kontekstit përkatës dhe vërtetimin e një praktike sjelljeje të qëllimshme.³¹ Në veçanti, Mbrojtja pretendon se: (i) Trupi Gjykses nuk saktësoi se cili kontekst duhej të qartësohej;³² dhe (ii) prova e marrë nuk vërteton se kush ishte përgjegjës për incidentet dhe rrjedhimisht nuk mund të përdoret për vërtetimin e një praktike sjelljeje të qëllimshme dhe për konstatimin në lidhje me relevancën.³³

23. ZPS-ja përgjigjet se pika e tretë nuk përbën pikë të apeluashme, duke qenë se pretendimet e Mbrojtjes janë të pabaza, hamendësuese dhe të parakohshme.³⁴

24. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Përgjigjja nuk trajton thelbin e pikës së ngritur në Kërkesë, dhe rithekson parashtimet e bëra në Kërkesë.³⁵

³¹ Kërkesa, para. 14.

³² Kërkesa, para. 15.

³³ Kërkesa, para. 18-20.

³⁴ Përgjigjja, para. 12-14.

³⁵ Kundërpërgjigjja, para. 12-14.

25. Trupi Gjykses rikujton se në Vendimin e Kundërshtuar u pajtua me Mbrojtjen se rrëmbimet e personave përkatës nuk janë fakte të paraqitura në Aktakuzë, dhe rrjedhimisht konstatoi se çdo provë e paraqitur në lidhje me to nuk mund të përdoret drejtpërdrejt si bazë për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarve lidhur me ato incidente.³⁶ Kur lejoi ZPS-së t'i bënte pyetje W01129-ës në lidhje me atë incident, Trupi Gjykses në fakt kufizoi përdorimin e lejueshëm të asaj prove vetëm për qartësimin e kontekstit përkatës dhe vërtetimin e një praktike sjelljeje të qëllimshme.³⁷ Trupi Gjykses është i mendimit se Mbrojtja shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar. Së pari Trupi Gjykses gjykon se, nga Vendimi i Kundërshtuar dhe nga historiku procedural dhe i provave lidhur me këto incidente të paraqitur edhe nga palët në parashtrimet e tyre,³⁸ del qartë se Trupi Gjykses iu referua kontekstit në të cilin pretendohet se ndodhën krimet e paraqitura në Aktakuzë. Së dyti, për sa i përket pretendimit të Mbrojtjes se konstatimi i Trupit Gjykses lidhur me relevancën ishte i mangët meqenëse nuk u paraqit asnjë provë që vërteton se kush ishte përgjegjës për këto incidente, Trupi Gjykses gjykon se këta faktorë nuk mund të merreshin parasysh në kuadër të lejimit të paraqitjes së dëshmisë dhe janë aspekte që Trupi Gjykses do t'i vlerësojë në fund të gjykimit, mbi bazën e të gjitha provave relevante. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se Mbrojtja keqkupton Vendimin e Kundërshtuar dhe thjesht shpreh mospajtim me konstatimet e bëra në të. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e tretë përbën një aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

26. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e tretë. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së tretë rrjedhimisht rrëzohet.

³⁶ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19981, rreshti 22, deri në f. 19982, rreshti 1, konfidencial.

³⁷ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 6-9; f. 19983, rreshtat 1-2, konfidencial.

³⁸ *Shih, p.sh.*, transkriptin e seancës, 18 shtator 2024, f. 19971, rreshtat 2-7; f. 19973, rreshtat 11-24; f. 19977, rreshti 15, deri në f. 19978, rreshti 15, konfidencial.

D. PIKA E KATËRT

27. Mbrojtja argumenton se në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses vlerësoi në mënyrë të gabuar dëmin e shkaktuar me pranimin e provës për incidentin e dytë,³⁹ duke qenë se në vlerësimin e vet nuk mori parasysh: (i) llojin dhe thelbin e provave që ZPS-ja kërkoi të paraqiste, që ishin rrëfime të dëgjuaara prej të tretëve e më tej; (ii) se Mbrojtja nuk ishte në gjendje të merrte në pyetje dëshmitarin në mënyrë të efektshme;⁴⁰ (iii) se nuk është e drejtë që prej Mbrojtjes të kërkohet ose pritët të hetojë një incident për të cilin nuk ishte njoftuar dhe i cili nuk ka bazën provuese dhe qartësinë faktike të duhur.⁴¹

28. ZPS-ja përgjigjet se pika e katërt nuk përbën pikë të apeluëshme, sepse Mbrojtja thjesht shpreh mospajtimin e vet me vlerësimin prej Trupit Gjykses të efektit dëmtues, dhe shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar.⁴²

29. Mbrojtja kundërpërgjigjet se Përgjigjja shtrembëron Kërkesën, në të cilën evidentohen gabime të qarta në vlerësimin e dëmit prej Trupit Gjykses. Mbrojtja gjithashtu thekson se Vendimi i Kundërshtuar në mënyrë të palejuëshme ia kaloi detyrimin e hetimit të incidenteve përkatëse Mbrojtjes.⁴³

30. Në Vendimin e Kundërshtuar, Trupi Gjykses vlerësoi nëse do t'i shkaktohej dëm Mbrojtjes po që se ZPS-së do t'i lejohej të paraqiste prova për rrëmbimet.⁴⁴ Në atë vendim, Trupi Gjykses mori parasysh: (i) nëse Mbrojtja ishte njoftuar për pyetjet e propozuara;⁴⁵ dhe (ii) nëse Mbrojtja do të kishte mundësi të plotë dhe të drejtë për t'i bërë pyetje dëshmitarit në lidhje me incidentet përkatëse.⁴⁶ Kur konstatoi se Mbrojtjes nuk do t'i shkaktohej asnjë dëm me lejimin e kësaj prove, Trupi Gjykses theksoi se

³⁹ Kërkesa, para. 21.

⁴⁰ Kërkesa, para. 22-23.

⁴¹ Kërkesa, para. 24.

⁴² Përgjigjja, para. 15-17.

⁴³ Kundërpërgjigjja, para. 16-17.

⁴⁴ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 10-25, konfidencial.

⁴⁵ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 10-14, konfidencial.

⁴⁶ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 15-17, konfidencial.

sipas nevojës, Mbrojtja do të mund të kryente hetime shitesë dhe të kërkonte që W01129 të thirrej përsëri në gjyq.⁴⁷ Trupi Gjykses është i mendimit se pika e katërt shtrembëron Vendimin e Kundërshtuar kur pretendon se Trupi Gjykses: (i) nuk mori parasysh asnjë nga faktorët e lartpërmendur kur vlerësoi dëmin; dhe (ii) i kërkoj Mbrojtjes, ose priste prej saj, që të hetonte incidentet. Në lidhje me hetimet, Trupi Gjykses vë në dukje se thjesht theksoi se Mbrojtja ka të drejtë të kryejë hetime të tilla, në rast se dëshiron, dhe të kërkojë që dëshmitari të thirret përsëri, po qe se do të ketë në zotërim material relevant të ri. Pika e katërt është thjesht mospajtim me rezultatin e vlerësimit të Trupit Gjykses dhe përpjekje për ta ngritur edhe njëherë aspektin e dëmit përmes përsëritjes së kundërshtimeve të njëjta të bëra para Vendimit të Kundërshtuar.⁴⁸ Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se pika e katërt përbën një aspekt që buron nga Vendimi i Kundërshtuar.

31. Duke pasur parasysh sa më lart, kriteret e tjera të standardit të miratimit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) dhe rregulla 77(2), nuk ka nevojë të trajtohen në lidhje me pikën e katërt. Kërkesa për leje për apelimin e pikës së katërt rrjedhimisht rrëzohet.

V. KLASIFIKIMI

32. Trupi Gjykses vëren se Kundërpërgjigjja është dorëzuar si konfidenciale. Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë për protokollim versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e saj, deri të **martën, 22 tetor 2024**.

⁴⁷ Transkripti i seancës, 18 shtator 2024, f. 19982, rreshtat 21-25, konfidencial.

⁴⁸ *Krahaso* transkriptin e seancës, 18 shtator 2024, f. 19970, rreshti 19, deri në f. 19971, rreshti 1; f. 19972, rreshtat 3-11, rreshti 14 deri në f. 19973, rreshti 9; f. 19974, rreshti 6, deri në f. 19975, rreshti 11, konfidencial, *me* Kërkesën, para. 21-24.

VI. VENDIM

1. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **RRËZON** Kërkesën; dhe
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë për protokollim versionin e redaktuar publik të Kundërpërgjigjes, ose të kërkojë riklasifikimin e saj, deri **të martën, 22 tetor 2024**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E martë, 15 tetor 2024

Hagë, Holandë.

Shënim shpjegues:

Në paragrafin 2, është fshirë referenca “Rexhep Selimi”.